



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Tiranë më 10.7.2024

Nr. 1892

Data: 9.7.2024

Nr: 71

Ora: 15:30

VENDIM

PËR
MIRATIMIN E PROGRAMIT TË EDUKIMIT, INFORMIMIT DHE
NDËRGJEGJËSIMIT TË ZGJEDHËSVE, PËR ZGJEDHJET E PJESSHME PËR
KRYETARIN E BASHKISË HIMARË TË DATËS 4 GUSHT 2024

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja “g” dhe 2, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

VENDOS:

1. Miratimin e programit të edukimit, informimit dhe ndërgjegjësimit të zgjedhësve për zgjedhjet e pjesshme për Kryetarin e Bashkisë Himarë, sipas materialit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 24 (njëzet e katër) orëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Data: 9.7.2024 Nr: 71
Ora: 15:30



“Për miratimin e programit të edukimit, informimit dhe ndërgjegjësimit të zgjedhësve, për zgjedhjet e pjesshme për Kryetarin e Bashkisë Himarë të datës 4 gusht 2024”



PROGRAMI PËR EDUKIMIN, INFORMIMIN DHE NDËRGJEGJËSIMIN E ZGJEDHËSVE

Zgjedhjet e pjesshme për Kryetar Bashkie Himarë
4 Gusht 2024



KQZShqiperi



KQZShqiperi



KQZShqiperi



KQZShqiperi



KQZShqiperi



kqz.gov.al

Përmbledhje Ekzekutive

Programi për edukimin zgjedhor të shtetasve për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë, të datës 4 gusht 2024, është një plan i detajuar i cili përcakton qëllimet dhe objektivat kryesore që duhet të realizohen për edukimin, informimin dhe ndërgjegjësimin e zgjedhësve përgjatë periudhës zgjedhore.

Programi për edukimin e shtetasve për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë të datës 4 gusht 2024, synon informimin, ndërgjegjësimin mbi të gjithë procesin zgjedhor që do të zhvillohet në këtë bashki, si dhe rritjen e pjesëmarrësve në zgjedhje.

Programet informuese do të realizohen nëpërmjet bashkëpunimit të KQZ-së me partnerë vendas dhe ndërkombëtarë. Përfshirja e tyre në realizimin e programeve edukuese zgjedhore, ekspertiza, angazhimi dhembështetja vlerësohen si komponentë të rëndësishëm në përmbushjen e misionit të KQZ-së.

Qëllimi i Programit

Programi për edukimin zgjedhor të shtetasve për zgjedhjet e pjesshme për Kryetarin e Bashkisë Himarë të datës 4 gusht 2024, ka për qëllim të informojë dhe ndërgjegjësojë zgjedhësit mbi aspektet kryesore të procesit zgjedhor. Në mënyrë specifike programi ka si qëllim të informojë dhe edukojë zgjedhësit në lidhje me procesin e verifikimit të emrit në listën e zgjedhësve, si dhe qendrën e votimit ku zgjedhësi voton, të informojë dhe edukojë zgjedhësit mbi procedurën e votimit dhe identifikimit elektronik, të informojë dhe edukojë zgjedhësit mbi plotësimin korrekt të fletës së votimit, ndërgjegjësimi dhe edukimi i grupeve vulnerabël dhe të rinjve votues për herë të parë për pjesëmarrje në zgjedhje, ndërgjegjësimi dhe edukimi i pakicave kombëtare, informimi i zgjedhësve mbi shkeljet dhe veprat penale që mund të kryhen gjatë procesit zgjedhor dhe i subjekteve zgjedhore, si dhe parandalimi i tyre.

Objektivat kryesore të programit janë:

1. Informimi, ndërgjegjësimi dhe edukimi i zgjedhësve për “Listën e zgjedhësve”.
2. Ndërgjegjësimi i zgjedhësve dhe subjekteve zgjedhore për ”Krimet Zgjedhore”, për rëndësinë e procesit zgjedhor, zhvillimin e zgjedhjeve të lira dhe të pandikuara.
3. Sensibilizimi i grupeve vulnerabël, të rinjve, kryesisht votues për herë të parë, gratë, etj, për të rritur pjesëmarrjen e tyre në votime.
4. Informimi i administratës publike për ndalimet dhe kriteret ligjore për zgjedhjet.
5. Informimi dhe edukimi i zgjedhësve mbi “Hapat që zgjedhësi duhet të ndjekë në Qendrën e Votimit”.
6. Informimi dhe edukimi i zgjedhësve mbi “Përmbajtjen e fletës së votimit dhe shënimin korrekt të saj”.

Realizimi i Objektivave

1. Informimi, ndërgjegjësimi dhe edukimi i zgjedhësve për listën e zgjedhësve, ku qëllimi është të informojë zgjedhësit se ku mund të gjejnë Qendrën e Votimit, në njësinë administrative, ku ata banojnë.

Mjetet

1. Media sociale
2. Takim me zgjedhësit
3. Spot tv
4. Led

Media sociale ku do të publikohen

Mediat sociale të KQZ- së

Takim me zgjedhësit

Takime me target grupet e synuara në Bashkinë Himarë

Led

Do të vendoset spoti "Lista e Zgjedhësve"

Periudha e transmetimit

Korrik 2024

2. Ndërgjegjësimi i zgjedhësve dhe subjekteve zgjedhore për rëndësinë e procesit zgjedhor, zhvillimi i zgjedhjeve të lira dhe të pandikuara, ku si qëllim ka të informojë zgjedhësit dhe subjektet zgjedhore mbi shkeljet dhe veprat penale që mund të kryhen gjatë procesit zgjedhor, si dhe parandalimi i tyre.

Mjetet

1. Media sociale
2. Spote tv
3. Takim me zgjedhësit
4. Postera në çdo QV
5. Billboard
6. Led
7. City lights

Media sociale ku do të publikohen

Mediat sociale të KQZ- së

Spotet

Tv lokale që mbulojnë bashkinë Himarë

Takim me zgjedhësit

Takime me target grupet e synuara në Bashkinë Himarë

Postera në çdo QV

Postera informues në të gjitha QV e Bashkisë Himarë

Billboard

Do të vendosen Billboard në pikat me lëvizje të dendur të qytetarëve

Led

Do të vendoset spoti “Krimet Zgjedhore”

Periudha e transmetimit

Korrik – 2024

3. Sensibilizimi i grupeve vulnerabël, të rinjve, kryesisht votues për herë të parë, gratë, ku qëllimi është rritja e pjesëmarrjes së tyre në votime. Ky objektivi ka në fokus sensibilizimin e zgjedhëseve gra, për të shmangur fenomenin negativ të votimit familjar në ushtrimin e të drejtës së tyre, për të votuar të lira dhe të pandikuara, votuesit për herë të parë, për të rritur pjesëmarrjen e tyre në zgjedhje.

Mjetet

1. Media sociale
2. Takim me zgjedhësit

Media sociale ku do të publikohen

Mediat sociale të KQZ-së

Takim me zgjedhësit

Takime me target grupet e synuara

Periudha e transmetimit

Korrik 2024

4. Informimi i administratës publike për ndalimet dhe kriteret ligjore për zgjedhjet, ku qëllimi kryesor është sensibilizimi i punonjësve të administratës shtetërore gjatë periudhës zgjedhore dhe informimi mbi shkeljet ligjore dhe veprat penale që mund të kryhen gjatë procesit zgjedhor, parandalimi i tyre, si dhe raportimi i çdo rasti në portalin e dedikuar për monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve shtetërore, para zgjedhjeve

Mjetet

1. Media sociale
2. Takim me zgjedhësit

Media sociale ku do të publikohen

Mediat sociale të KQZ-së

Takim me zgjedhësit

Takime me target grupet e synuara

Periudha e transmetimit

Korrik 2024

5. Informimi dhe edukimi i zgjedhësve mbi hapat që zgjedhësi duhet të ndjekë në Qendrën e Votimit, si dhe procedurat e identifikimit elektronik në procesin e votimit, ku qëllimi është informimi për hapat që ndjek zgjedhësi në QV, së bashku me identifikimin elektronik të zgjedhësve që kryhet nga aparatura e identifikimit elektronik.

Mjetet

1. Media sociale
2. Spote tv
3. Takim me zgjedhësit
4. Postera në çdo QV
5. Led

Media sociale ku do të publikohen

Mediat sociale të KQZ-së

Spotet

Tv lokale që mbulojnë bashkinë Himarë

Takim me zgjedhësit

Takime me target grupet e synuara në Bashkinë Himarë.

Postera në çdo QV

Postera informues në të gjitha QV e Bashkisë Himarë

Led

Do të vendoset spoti “Hapat e procesit të votimit”

Periudha e transmetimit

15 korrik-04 gusht 2024

6. Informimi dhe edukimi i zgjedhësve mbi mënyrën e votimit, përmbajtja e fletës së votimit dhe shënimin korrekt të saj. Zgjedhësit të jenë të përgatitur ditën e votimit për plotësimin e fletës së votimit që vota e tyre të jetë e vlefshme dhe informimin që ata votojnë vetëm për Kryetarin e Bashkisë Himarë.

Mjetet

1. Media sociale
2. Spote tv
3. Takim me zgjedhësit
4. Led

Media sociale ku do të publikohen

Mediat sociale të KQZ-së

Spotet

Tv lokale që mbulojnë bashkinë Himarë

Takim me zgjedhësit

Takime me target grupet e synuara në Bashkinë Himarë.

Led

Do të vendoset spoti “Plotësimi i fletës së votimit”

Periudha e transmetimit

Korrik- 4 Gusht 2024

Sfidat e Programit

Sfida kryesore e këtij programi edukimi dhe ndërgjegjësimi është realizimi i tij në kohë dhe me standard, për të arritur qëllimet dhe përmbushur objektivat, si dhe në dhënien e marrjen e informacionit të nevojshëm rreth procesit zgjedhor, për zgjedhjet e pjesshme që do të zhvillohen në datën 4 gusht 2024.

Duke vlerësuar faktin që koha në dispozicion është shumë e shkurtër, si dhe konsensusin e të gjithë aktorëve të përfshirë në proces, zbatimi i këtij programi është sfidë për përmbushjen e misionit të KQZ-së.